2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
  - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se ulja e ofertës sonë nga fondi maksimal, i llogaritur në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, **do të jetë jo më pak se përqindja e përcaktuar në tabelën e mëposhtme:**

**Lista e Çmimeve (Tabela e uljes së ofertës e shprehur në përqindje)**

	GRUPI 1	GRUPI 2	GRUPI 3	GRUPI 4	GRUPI 5
NDERTESAT DHE NDARJET FUNKSIONALE					
STRUKTURAT NE AMBJENTET E JASHTME					
VEPRAT INXHINIERIKE (NDERTIM)					
VEPRAT INXHINIERIKE (MIREMBAJTJE)					
STRUKTURAT MBAJTESE					
STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT					
SISTEMET TEKNIKE					

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

**Shërbimi që kërkohet:** “Shërbime për përgatitjen e projekteve të zbatimit në KESH sh.a”.

**Afatet e ekzekutimit:** 24 (njëzet e katër) muaj nga hyrja në fuqi e marrëveshjes kuadër/ Ose me mbarimin e fondit limit. *Kohëzgjatja e kontratave që do të lidhen në vijim të minitenderave do të përcaktohet sipas termave të referencës për secilin objekt.*


**Grafiku i ekzekutimit do të jepet në detyrën e projektimit që do të dërgohet për secilin minitender.**

---

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

#### 1. TË PËRGJITHSHME

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a., është kompani publike në Shqipëri dhe është gjithashtu prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në Shqipëri. Prodhimi i energjisë elektrike kryhet kryesisht përmes shfrytëzimit të energjisë ujore të lumit Drin, duke zotëruar mbi 70% të kapaciteteve prodhuese në vend. KESH sh.a. si prodhues publik, mbulon rreth 75% të kërkesës për energji elektrike të klientëve tariforë si dhe siguron energjinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve në sistemin e transemitimit.

KESH sh.a., kryen një aktivitet ekonomik i cili konsiston në shfrytëzimin (operimin) dhe administrimin e hidrocentraleve të Fierzës, Komanit dhe Vau Dejës, që janë tre hidrocentralet më të mëdhenj të vendit të ndërtuar në kaskadën e lumit Drin. Aktiviteti ekonomik i KESH sh.a. sigurohet duke u bazuar në kuadrin ligjor respektiv, në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në Ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” dhe në VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, ku KESH sh.a. si shfrytëzues i digave të kaskadës së lumit Drin, ka detyrimin ligjor të garantojë shfrytëzimin normal të objekteve, jetëgjatësinë e tyre dhe mosçënimin e të “tretëve”, e parashikuar kjo që në fazën e projektimit, e të ndërtimit dhe duke vazhduar edhe gjatë shfrytëzimit, dhe mirëmbajtjes së veprave.

Menaxhimi i këtyre hidrocentraleve ka një rëndësi të madhe jo vetëm për garantimin e prodhimit të energjisë elektrike për Shqipërinë, por edhe për të garantuar sigurinë e veprave në aspektet teknike, fizike, mjedisore dhe më gjerë. Këto faktorë janë thelbësorë në ekonominë e vendit dhe në sigurinë e jetës gjithashtu.

Bazuar në Ligjin Nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për emergjencat civile”, si dhe ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave si dhe në rregulloren për “Sigurinë e Digave dhe Dambave”, një ndër detyrat kryesore të KESH sh.a. është edhe monitorimi profesional i situatave emergjente që mund të krijohen si rezultat i problematikave të mundshme në digat e kaskadës së lumit Drin.

Lumi Drin është lumi më i madh në Shqipëri me pellg ujëmbledhës në total prej afro 14 173 km<sup>2</sup>. Deri në vitin 1985 në këtë lum janë ndërtuar tre hidrocentrale të mëdhenjtë cilët administrohen nga KESH sh.a. deri në vitin 1985 duke krijuar kaskadën e lumit Drin me treliqene të mëdha, ku për krijimin e tyre janë ndërtuar gjashtë diga të mëdha, ku më e larta është diga e Fierzës me lartësi 165,5 m dhe gjatësi të kreshtës së saj prej 380 metra linear.

**Diga e Fierzës** ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1978 si rrjedhojë e të cilës është krijuar liqeni i Fierzës me vëllim të projektuar afro 2.7 miliard m<sup>3</sup> dhe sipërfaqe prej afro 72.6 km<sup>2</sup>. Volumi aktual i liqenit të Fierzës, referuar matjeve batimetrike të viteve 2015 dhe 2023, është rreth 2.2 miliardë m<sup>3</sup> ujë. Diga e Fierzës ndodhet afro 15 km larg qytetit të Bajram Currit dhe 193 km larg qytetit të Tiranës.

---

**Diga e Komanit** ka përfunduar së ndërtuari vitin 1985 si rrjedhojë e të cilës është krijuar liqeni i Komanit me vëllim të projektuar prej rreth 500 milion m<sup>3</sup> dhe sipërfaqe prej rreth 13 km<sup>2</sup>. Volumi aktual i liqenit të Komanit, referuar matjeve batimetrike të viteve 2015 dhe 2023, është rreth 440 milionë m<sup>3</sup> ujë. Diga e Komanit ndodhet në rrjedhën e poshtme të digës së Fierzës rreth 38 km më poshtë se diga e Fierzës.

**Digat e Vaut të Dejës** kanë përfunduar së ndërtuari në vitet 1970 si rrjedhojë e të cilës është krijuar liqeni i Vaut të Dejës me vëllim të projektuar prej rreth 580 milion m<sup>3</sup> dhe sipërfaqe prej 25.5 km<sup>2</sup> dhe gjatësi prej 30 km. Volumi aktual i liqenit të Vaut të Dejës, referuar matjeve batimetrike të viteve 2015 dhe 2023, është rreth 512 milionë m<sup>3</sup> ujë. Në HEC Vau i Dejës janë ndërtuar 4 diga kryesore (Diga e Qyrsaqit, Zadejës, Rragamit dhe Gjoçit) kuota e kreshtës së të cilave është 79.00 mmnd.

## **2. NEVOJA PËR MIRËMBAJTJE E OBJEKTEVE.**

Referuar detyrimit ligjor që KESH sh.a. si Shfrytëzues i digave të Kaskadës së lumit Drin ka për mirëmbajtjen e objektet e sipërcituara (HEC-et Fierzë, Koman dhe V. Dejës), të cilët janë objekte të rëndësisë së veçantë, kryhen edhe parashikimet afatgjata, afatmesme dhe prioritare të investimeve me qëllim mirëmbajtje e tyre. Sipas kontrolleve, inspektimeve dhe monitorimeve permanente të stafeve teknike të KESH sh.a., rezulton se në këto hidrocentrale dhe në territoret rreth tyre, ka nevoja të vazhdueshme për realizimin e investimeve për mirëmbajtjen e veprave hidroteknike, ndërtime të reja inxhinierike, ndërtim dhe mirëmbajtje të rrugëve lidhëse dhe operuese të tyre, ndërhyrje në sistemet teknike egzistuese, projektim apo montim të sistemeve të reja operuese, ndërtime civile, ndarje funksionale apo mirëmbajtje të atyre egzistuese, etj.

## **3. QËLLIMI I SHËRBIMIT**

Qëllimi i shërbimit do të jetë për të përmbushur detyrat e kërkuara në Programin Ekonomik dhe Financiar të KESH sh.a. sipas nevojave për hartimin e projekteve në kuadër të investimeve të mundshme të mirëmbajtjes së veprave, që KESH sh.a. Projektet që do të realizohen do të jenë projekte për investimet që do të kryhen në HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau Dejës, sipas programeve të mirëmbajtjes dhe investimeve të reja të ndryshme që i kërkon koha dhe operimi i sigurte i veprave.

Sa më sipër kërkohet të realizohet në kuadër të mirëmbajtjes së objekteve, zonave përreth tyre, sistemeve teknike, si dhe investimeve me karakter social e mjedisor në zonat e influencës së këtyre HEC-eve.

## **4. DETYRAT KRYESORE QË DUHET TË ZGJIDHË PROJEKTI I ZBATIMIT.**

Nëpërmjet projekteve që do të porositen në zbatim të Marrëveshjes Kuadër me objekt “Shërbime për përgatitjen e projekteve për punimet e mirëmbajtjes në Njësitë e Prodhimit të HEC-ve Fierzë, Koman dhe Vau Dejës”, kërkohet të sigurohen projekte të detajuara, duke përfshirë përmbushjen e kërkesave të mëposhtme:

- Njohjet me Detyrat e Projektimit dhe të Termave të Referencës.
- Investigimin zonës ku kërkohet kryerja e investimit (Rast pas rasti) dhe rikonicionimin e saj me Detyrën e Projektimit.

- 
- Përshkrimi i situatës aktuale të çdo objekti rast pas rasti në një Raport Fillestar, i cili identifikon plotësisht problematikën dhe nga ku nis edhe hartimi i Projekt Ideve dhe Projektit të Zbatimit.

Për të realizuar më pas Projektet e Zbatimit (Rast pas rasti), duhet të kryhen dhe të përmbushen kërkesat ligjore të hartimit të projekteve dhe të Detyrës së Projektimit, duke kryer por duke mos u limituar vetëm këtu, në:

- Kryerja e matjeve fillestare topografike apo batimetrike të zonës ku kryhet investimi. Përgatitja e Raportit përkatës.
- Studime dhe/ose Raporte Gjologjike,
- Vlerësimin e volumeve të punës dhe llojit të çdo materiali që do të përdoret.
- Specifikimet Teknike të materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren.
- Studime/elektromekanike.
- Studimi hidrologjik.
- Studime Mjedisore (*Studimi dhe vlerësimi i ambientit VNM*), etj.
- Hartimin e Projekt-Ideve dhe Projekt Zbatimit, duke i paraqitur me vizatimet e tyre përkatëse me programe kompiuterike sipas kërkesave ligjore dhe kërkesave të Detyrës së Projektimit.
- Hartimin e Projekt Preventivit sipas sipas kërkesave ligjore dhe kërkesave të Detyrës së Projektimit (*Hartimi i Preventivit dhe Analizave të çmimit sipas legjislacionit në fuqi*).
- Plani i Sigurisë në Punë.
- Kërkesa të veçanta që do të lindin sipas projektit që do të realizohet për çdo minitender.

## **5. STANDARTET TEKNIKE QË DO TË PËRDOREN NË HARTIMIN E PROJEKTIT.**

Projekti do të hartohet në përputhje me normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi dhe kërkesave të Detyrës së Projektimit dhe Termave Teknike të Referencave. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve teknike të projektimit dhe të zbatimit dhe eksperiencave më të mira botërore referuar ngjashmërive të dukurive natyrore të Shqipërisë me ato vende. Në mënyrë të veçantë, projektuesit duhet të respektojnë në të gjitha fazat e përgatitjes së projektit, kërkesat e Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000, “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave”, si dhe të VKM Nr.147, dt. 18.03. 2004.

Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse në fuqi. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim, duke përfshirë edhe rekomandimet e ICOLD. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të besueshmërisë dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe kufizimet për financimin e veprës. Detajet teknike duhet të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

---

## **6. PROFILI I EKSPERTËVE DHE SHOQËRIVE PROJEKTUESE.**

Ekipi i projektuesve duhet të demonstrojë aftësi profesionale, eksperiencë dhe mundësi teknike në fushën e kryerjes së studimeve dhe projekteve sipas çdo kërkesë të veçantë për çdo projekt rast pas rasti. Ky ekip duhet të paraqesë eksperiencat e tyre në fushën e studimeve dhe projektiveve sipas objektit për të cilin do të kërkohet projekt në përgjithësi dhe atyre të digave në veçanti. Ekipi duhet të vendosë në dispozicion informacionin e duhur në lidhje me eksperiencën e tij në projekte të ngjashme. Gjithashtu projektuesit dhe/apo bashkëpunorët e tyre, duhet të jenë ekspertë që i përkasin fushave inxhinierike që do të kërkohet në çdo minitender.

**Shënim:** Të gjithë informacionet e nevojshme dhe kërkesat e veçanta do të jepen së bashku me ftesën për ofertë që do të dërgohet për secilin minitender. Për çdo minitender do të përcaktohet detyra e projektimit dhe kërkesat e tjera.



---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

---

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

---

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sa më sipër.**

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Liçencën e Shoqërisë për projektim, të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj, në kategoritë si më poshtë:

### 2.PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

### 3.PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- 
- a) Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
  - c) 1.Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.
  - d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

#### 4. PROJEKTUES INSTALATOR

- a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
- b) Projektim të instalimeve termoteknike – kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- f) Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- h) Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, etj.)
- i) Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.
- j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile e industriale.

#### 5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- a) Diga të mëdha (diga me lartësi mbi 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar mbi 1 milion m<sup>3</sup> ose gjatësi kurore dige mbi 500 ml).
- d) Vepra ujitje – kullimi – impiante vaditëse – diga te vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha)– damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.
- f) Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi– shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

#### 6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

- a) Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

#### 7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

- a) Ura dhe vepra arti të vogla deri me 10 m.

#### 8. PROJEKTUES GJEODET

---

a) Rivelime inxhinierike.

d) Bazamente gjeodezike.

## 9. STUDIM GJEOLLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

c) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.

d) Studim/Vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

e) Studime e projektme hidrogjeologjike.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës).

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për periudhën Maj 2024 – Korrik 2024 minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nga të cilët minimalisht 8 (tetë) punonjës duhet të jenë drejtues teknik të shoqërisë :

- ✚ 1 (një) Inxhinierë Hidroteknike,
- ✚ 1 (një) Inxhinierë Ndërtimi,
- ✚ 1 (një) Inxhinier Ndërtimi me profil Strukturist,
- ✚ 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- ✚ 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- ✚ 1 (një) Inxhinier Mekanik
- ✚ 1 (një) Inxhinier Elektrik
- ✚ 1 (një) Inxhinier Mjedisi

*Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaratimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit si:*

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomë;
- ✚ Licensë individuale profesionale
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Maj 2024 – Korrik 2024.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të përmbledhë të dhenat për inxhinieret e kërkuar më sipër sipas tabelave në vijim:

POZICIONI	EMRI MBIEMRI I SPECIALISTIT TË PROPOZUAR PËR KËTË POZICION	DIPLOMA QË ZOTERON	EKSPERIENCA NË MBIKEQYRJE (VITE)
Inxhinier Hidroteknik			
Inxhinier Ndërtimi			
Inxhinier Ndërtimi me profil Strukturist			
Inxhinier Gjeodet			
Inxhinier Gjeolog			
Inxhinier Mekanik			
Inxhinier Elektrik			
Inxhinier Mjedisi			

*Asnjë nga inxhinierët e mësipërm sipas tabelës, nuk duhet të jenë të angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.*

*Në rastet e bashkimit të shoqërive deklarata e mësipërme duhet të firmoset nga të gjithë përfaqësuesit e autorizuar të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001 - “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”
- b) ISO 14001 - “Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit”
- c) ISO 45001 - “Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë”;

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmenden “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve**

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

**B: DEKLARATË**

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të</p>



përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.
